



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.70/2016

Prishtinë, më 4.10.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berish – Shala, Fatmir Rexhepi, Rustem Berisha dhe Enver Hoti, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Fjolla Uka – KDI, Dardan Abazi – INDEP, Lekë Batalli – GLPS dhe Etleva Malushi – LVV.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 27.9.2016;
3. Shqyrtimi i listës së kandidatëve për bordin e Autoritetit të Hekurudhave të Kosovës, të propozuar nga Qeveria;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.9.2016;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 27.9.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i listës së kandidatëve për bordin e Autoritetit të Hekurudhave të Kosovës, të propozuar nga Qeveria;

Muhamet Mustafa, kryetar: Në mbledhjen e kaluar kemi zhvilluar debat, ndërsa sot propozoj që të kalojmë në votim, përpos që nëse dikush ka vërejtje konkrete për kandidatë të caktuar, ndonjë vërejtje të rëndësishme që ta përfshijmë në raportin tonë që e dërgojmë në Kuvend.

Besim Beqaj, tha se kemi diskutuar edhe javën e kaluar për kandidatin për kryetar në Bordin e Autoritetit të Hekurudhave të Kosovës, kemi pritë të marrim informata më shumë, sa unë kam informacion diplomat duhet të jenë të nostrifikuara. Ai propozoi që para se të shkojë në seancë propozimi i Qeverisë, të marrim informacion se a duhet të nostrifikohet diploma. Unë, tha Beqaj, jam konsultuar dhe në bazë të bisedave që kam bërë me zyrtarë nga ministria, kërkohet nostrifikimi, por ne duhet të shkruajmë qartë në raport që Qeveria të na njoftojë me shkrim. Në fund tha, jam i përmbajtur në votim vetëm sa i përket kësaj çështje.

Pas debatit, Komisioni me 6 (gjashtë) vota “për”, dhe 1 (një) “abstenim”, nxori këtë

Rekomandim

1. Të emërohet Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, i propozuar nga Qeveria, më mandat 5 (pesë) vjeçar, si vijon:

- 1. Arsim Berisha, kryesues,*
- 2. Shkumbin Hyseni, anëtar,*
- 3. Ilmi Ahmeti, anëtar dhe*
- 4. Gëzim Qerimi, anëtar.*

2. Arsytimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

4. Të ndryshme

a) Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit për planifikimin e vizitës në ARKEP, pas përfundimit të mbledhjes së Komisionit.

b) Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit se Projektligji për “Trepçën”, pritet të miratohet sot ose nesër në Qeveri dhe do të vjen në Kuvend. Ne për shkak të çështjeve procedurale fatkeqësisht na zvogëlon shumë kohën, por ne duhet të mobilizohemi dhe këtë kohë që e kemi ta shfrytëzojmë në mënyrën më të mirë dhe përgjegjësinë më të lartë për me e trajtua këtë

Projektligj. Mund të ndodhë që ne të kemi mbledhje të enjten, mandej të shohim të mbajmë dëgjim publik dhe diskutime me përfaqësuesit e “Trepçës”, diskutime me ekspertë të së drejtës pronësore dhe biznesore. Ne duhet të jemi të sigurt që të gjitha gjërat që i bëjmë të jenë në linjë të një “Trepçe” prosperuese. Leximi i parë i Projektligjit për “Trepçën” mund të jetë të premten.

Besim Beqaj, theksoi se të gjitha shqetësimet është mirë ti trajtojmë në mënyrë faktike, profesionale dhe me koka të ftohta të mendojmë për çështjet madhore siç është çështja e “Trepçës”.

Rrustem Berisha, shtroi pyetje se si kaloi Projektligji në Kryesi dhe e kanë caktuar për seancë, ndëkohë që ne nuk e kemi ende draftin.

Sala Berisha – Shala, kërkoi sjelljen e Projektligjit nga Qeveria në Kuvend dhe theksoi se është e mjaftueshme koha nga leximi i parë për ndryshime dhe përmirësime në përmbajtje nga ana e anëtareve të Komisionit.

Enver Hoti, shprehu shqetësimin për Projektligjin për “Trepçën”. Ky Projektligj po shihet se ka filluar mbrapsht, duke u nisur nga propozimi i Kryesisë, nuk po mundet t’i jepet drejtimi i duhur “Trepçës”. Mund të ketë agjenda dhe ndikime tjera politike, me këto procedura dhe veprime të zhvilluara nga Qeveria karshi kësaj teme, neve na lë për të dëshiruar shumë, dhe për të besuar se ka agjenda përtej kësaj çfarë shihet.

Fatmir Rexhepi, shprehu brengosjen për vonim në procedim të Projektligjit nga ana e Qeverisë. Ai kritikoi po ashtu edhe Kryesinë për procedim në seancën e ardhshme, ku thotë se as në aspektin ligjor dhe as në aspektin parlamentar nuk është në rregull dhe e mbështeti punën e kryetarit të Komisionit në vazhdimësi rreth këtij Projektligji.

Besim Beqaj, theksoi se pavarësisht dallimeve partiake, mendoj se në Projektligjin për “Trepçën” kemi një synim të përbashkët, që Ligjin për “Trepçën” ta rregullojmë sa më mirë që dimë dhe mundemi. Beqaj kërkoi angazhim maksimal në punë rreth këtij Projektligji nga momenti që vjen Ligji nga Qeveria në Komision.

Rrustem Berisha, kërkoi hapësirë kohore që të marrin qëndrimet partiake rreth këtij P:projektligji, duke theksuar se qasja ndaj Projektligjit për “Trepçën” i tejkalon bindjet politike.

Kryetari, kërkoi mobilizim të anëtareve të Komisionit dhe organizim në grupet parlamentare për analizim, shqyrtim të Projektligjit nga ana e subjekteve politike dhe tha se çdo propozim konstruktiv do të shqyrtohet me kujdesin më të madh.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa